



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Ministria e Punëve të Brendshme

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (631)

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- SPB Shkup ka dorëzuar raport për formularët e lëshuar dhe targat e regjistrimit deri te seksioni për çështje financiare përfundimisht me 31.12.2018, për shkak se nuk është kryer me kohë zvogëlimi i stoqeve të formularëve dhe targave në raportet financiare,
- Të ardhurat nga pasaportat e lëshuara, letërnjoftimet, patentë shoferit, leje trafiku, targat e regjistrimit dhe formularët tjerë, nuk evidentohe në pajtim me bazën mbi të cilën realizohen ato.

Mendimi i dhënë/përfundim*:



Me revizionin e kryer për vitin 2020, shprehëm mendim me rezervë për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- Të vendoset evidenca analitike e të hyrave në pajtim me bazën mbi të cilën realizohen,
- Të vendoset mekanizmi i kontrollit për monitorimin e pagesave të realizuara dhe formularëve të lëshuara dhe të kryet harmonizimi periodik.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Dobësi sistematike që i referohet mospërputhjes reciproke të akteve ligjore që rregullojnë të drejtën e pagesës së largimit që i paguhet punonjësit pas daljes në pension.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga personi i autorizuar i Ministrisë janë marrë vërejtje te draft-raporti i revizorit të autorizuar shtetëror.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtjet janë rishikuar dhe është konstatuar se tri vërejtje paraqesin njoftim për aktivitetet e ndërmarra për tejkalimin e gjendjes së konstatuar në draft-raportin.

*



pozitive



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur